



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH	NTSH "LIRIA" ("Ndërmarrja")
Emri i Ndërmarrjes së Re	Ndërmarrja e Re Liria "Salloni i Mobileve" SH.P.K. (Ndërmarrja subsidiare) Ndërmarrja e Re e ofruar për shitje përfshin vetëm kompleksin komercial/salloni i mobileve e përshkruar si me poshtë. Asetet e ngelura të Ndërmarrjes nuk ofrohen për shitje, ato do të privatizohen veçmas.
Vendndodhja	Prizren, Regjioni i Prizrenit
Biznesi/Spektori	Hapësirë për shitje me pakicë.
Prodhimet	Ndërmarrja lëshon me qira palëve të treta hapësirë për tregti me pakicë të cilën e shfrytëzojnë për aktivitete të ndryshme të shitjes me pakicë të produkteve jo-ushqimore. Kompleksi komercial/salloni i mobileve që ndodhet në zonën primare të qytetit të Prizrenit, përfshin ndërtesën që përmban bodrumin, katin përdhës dhe nën kulmin (B+P+nk). Aktualisht kompleksi komercial/salloni i mobileve është i dhënë me qira palëve të treta.
Tregu	Tregu i patundshmërive komerciale mund të ndahet në tregun me pakicë, për deponim/industri dhe hapësirë për zyre. Në Kosovë, dy segmentet kryesore të shitjes me pakicë janë ushqimi dhe veshmbathja. Shitjet tjera me pakicë përfshijnë shitoret e specializuara që shesin CD/DVD, barëra, artikuj argjentarie, pjesë për vetura dhe mobile. Tregu me pakicë në Kosovë është shumë i ndarë dhe dominuar nga biznese të vogla familjare.
Konkurrenca	Tregu i hapësirave me qira për shitje me pakicë në Prizren, sikur në tërë Kosovën, është shumë i ndarë dhe kompetitiv. Gjithashtu ndërmarrja ka një ndër portofolet më të mëdha individuale për shitje me pakicë në Prizren, ndërmarrja subsidiare përfaqëson vetëm një pjesë të vogël të tregut. Konkurrentët janë të ndryshëm dhe përfshijnë NSH të tjera, një numër të madh të investitorëve të pronës private, dhe një numër i vogël të pronarëve privat. Me rëndësi është të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e hapësirës me qira për shitje me pakicë ende i takon NSH-ve ku qiramarrësit rrallë i mbulojnë obligimet e veta të qirasë.
Punonjësit	Të gjithë punëtorëve të Ndërmarrjes iu është ndërprerë marrëdhënia e punës më 30/11/2010.

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencialë inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencialë këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së:

<http://www.pak-ks.org>

Ndërtesat dhe tokat

Ndërmarrja e Re Liria “Salloni i Mobileve” përfshin kompleksin komercial/ndërtesën që përmban bodrumin me rreth 900 m², katin përdhës me rreth 950 m² dhe nën kulmin me rreth 50 m² (B+P+nk), dhe ndodhet në rrugën “Zahir Pajaziti” p.n në zonën primare të qytetit të Prizrenit. Sipërfaqet e prezantuara si më lartë janë sipas matjeve interne dhe jo zyrtare.

Sipërfaqja totale e kompleksit komercial/salloni i mobileve sipas fletës poseduese/certifikatës mbi të drejtat e pronësisë së paluajtshme nr. 5408 dhe kopjes së planit, të datës 23/03/2009 është 3108m² dhe aktualisht e regjistruar në emër të KK-Prizren. **Jo e tërë sipërfaqja e paraqitur në fletën poseduese nr. 5408 do të bartet në emër të NSH-së.**

Më 12/05/2009 ZR e AKP-Prizren ka bërë kërkesë në ZKK-Prizren për bartje të pronës në emër të NSH “Liria” si dhe më 05/02/2010 kërkesë për matje/incizim të gjendjes faktike të kompleksit komercial/salloni i mobileve.


Më 31/03/2011 ZKK-Prizren ka lëshuar Kopjen e Planit ku është cekur sipërfaqja e jashtme/gabariti i objektit të sallanit të mobileve të jetë 1016 m². **Megjithatë, përfundimisht sipërfaqja e saktë do të dihet pas bartjes së pronës në emër të NSH-së nga ana e drejtorive përkatëse të KK Prizren.**

Kërkesa e fundit e AKP-së për bartje të pronës sipas azhurnimeve të fundit nga ZKK Prizren, në Drejtorinë për Pronësi KK Prizren është dorëzuar me datë 05/04/2011.

Detyrimet që do të barten

- (1) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të.
- (2) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri, **(nëse ka)**.
- (3) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-se në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
 - a. Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
 - b. Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

Foto inqizimi ajror i Ndërmarrjes së Re



Informatat

Departamenti i Shitjes
Agjencioni Kosovar i Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 500 400
www.pak-ks.org

Dokumentet e ofertimit

Agjencioni Kosovar i Privatizimit
Rr: Ilir Konushevci Nr:8
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat rreth Ndërmarrjes së Re të prezentuar në këtë Të Dhëna nuk janë të përligjura. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së:
<http://www.pak-ks.org>